



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government



Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute of Public Health of Kosova

BULETINI MUJOR I SËMUNDJEVE NGJITËSE

Mars, 2025

01-31 mars, 2025

PËRMBAJTJA E
BULETINIT

1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse gjatë muajit mars 2024 dhe 2025
2. Sëmundjet e raportuara në Kosovë, sipas komunave
3. Rastet e spitalizuara nga sëmundjet ngjitëse
4. Epidemitë e lajmëruara
5. Niveli i raportimit nga institucionet shëndetësore
6. COVID-19
7. Situata epidemiologjike në rajon dhe botë

QËLLIMI:

Që të përcillet dhe vlerësohet situata epidemiologjike me sëmundje ngjitëse në Kosovë, trendin e sëmundjeve ngjitëse, momentet me valide epidemiologjike, shkallën dhe kualitetin e raportimit të institucioneve shëndetësore me qëllim të përforcimit të parandalimit dhe përgjigjes epidemiologjike.

1. NUMRI I RASTEVE DHE VDEKJEVE NGA
SËMUNDJET NGJITËSE GJATË MUAJIT MARS
2025 DHE 2024

Gjatë muajit mars 2025 janë raportuar **18,760 raste** me sëmundje ngjitëse **Inc.(1,052.68 raste /100, 000 banorë)**. Ky numër i rasteve është më i ultë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit **2024 (19,212 raste ose Inc 1,078.04 raste/100,000)**. Sëmundjet të cilat prijnë me numër më të lartë të rasteve janë: **Influenca sezonale (ILI) me 12,517 raste ose 702.37/100,000 banorë, Sindroma diareale me 3,673 raste ose 206.10/100,000 banorë, dhe ARI/ITPR me 1,876 raste ose 105.27 në 100,000 banorë (Tab.1).**

Gjatë muajit mars 2025 janë raportuar 6 raste të vdekjes nga sëmundjet ngjitëse: 2 raste me dg. me Infiltratio pulmonum me diagnozë përcjellëse, 1 rast me dg. Influenca A me diagnozë përcjellëse, 1 rast me St. post Meningoencephalitis purulenta me diagnozë përcjellëse, 1 rast me dg. Hepatititis chronica B me diagnozë përcjellëse, dhe 1 rast me dg. Hepatitis B fulminans me diagnozë përcjellëse.

2. SËMUNDJET NGJITËSE TË RAPORTUARA NË KOSOVË SIPAS KOMUNAVE, MARS 2025

Gjatë muajit mars 2025 në IKShPK, nga grupi i sëmundjeve që raportohen me numrin më të lartë, (shih Tabela 1)

Influenca sezonale /ILI: Gjatë muajit mars 2025 në IKShPK janë raportuar 12,517 raste me ILI (Inc. 702.37/100,000 banorë). Sipas numrit të rasteve të raportuara vërehet rritje prej 4.23% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak me (12,008 raste) por krahasuar me muajin paraprak, shkurt 2025 me (22,449 raste të raportuara me ILI) vërehet ulje prej 44.24%, karakteristike kjo për sezonën dhe uljen e aktivitetit të qarkullimit të patogjenëve respirator.

Sindroma diareale: Gjatë muajit mars 2025 në IKShPK janë raportuar 3,673 raste me sindromë diareale (Inc.206.10/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (4,361 raste), vërehet një ulje prej 15.77% dhe gjithashtu krahasuar me muajin shkurt 2025, me 4,094 raste të raportuara, ulje prej 10.28%. Megjithatë numër ky i konsideruar i rasteve të raportuara i cili mbetet shqetësim për shëndetin publik, pasojë kjo e ekspozimit ndaj patogjenëve të ndryshëm në ushqim dhe ujë.

ARI/ITPR: Gjatë muajit mars 2025 në IKShPK janë raportuar 1,876 raste me ARI (Inc.105.27/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (1,888 raste) vërehet një ulje prej 0.63% por krahasuar me muajin paraprak shkurt 2025 me (1,104 raste) të raportuara, rritje prej 69.9%.

Variçella: Gjatë muajit mars 2025 në IKShPK janë raportuar 371 raste me Variçellë (Inc.20.82/100,000 banorë) dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 me (744 raste) vërehet ulje prej 50.13% e rasteve të raportuara dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak shkurt 2025 me (331 raste), ulje prej 12.08%.

**Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse të raportuara në Kosovë,
01 – 31 mars të vitit 2024 dhe 2025**

Tabela 1.

Numri i rasteve të sëmundjeve ngjitëse dhe Incidenca/100,000 banorë në Kosovë, mars 2024 dhe 2025				
Sëmundjet/shkaktarët	mars, 2024		mars, 2025	
	Nr. i rasteve	Incidenca/ 100,000	Nr. i rasteve	Incidenca/ 100,000
COVID-19	4	0.22	0	0
ITPR - Pneumonia/ARI	1888	105.94	1876	105.27
SARI (infeksion i rëndë akut respirator)	15	0.84	19	1.07
Sëmundje e ngjashme me gripin (ILI)	12008	673.81	12517	702.37
Influenca A	18	1.01	21	1.18
Influenca B	6	0.34	44	2.47
RSV	33	1.85	15	0.84
Diarea akute	4361	244.71	3673	206.10
Variçela	744	41.75	371	20.82
Sindromi meningjeal	8	0.45	13	0.73
Helmimet me ushqim	40	2.24	19	1.07
Salmonella enteritidis	4	0.22	5	0.28
Infeksionet virale dhe infeksionet tjera specifike intestinale me Rotavirus	1	0.06	13	0.73
Gastroenterokolitet	11	0.62	30	1.68
Hepatiti akut A	1	0.06		0.00
Hepatiti akut B	4	0.22	4	0.22
Hepatiti akut C		0.00		0.00
Morbilli			3	0.17
Parotiti epidemik	5	0.28	1	0.06
Pertussis	14	0.79	3	0.17
Rubeolla			1	0.06
TB			81	4.55
Tularemia	2	0.11	1	0.06
Brucellosis	1	0.06	5	0.28
Echinococcus	1	0.06		0.00
Leptospira	1	0.06		0.00
Toxoplasmosis	1	0.06		0.00
Legionella		0.00		0.00
Leishmaniazë		0.00		0.00
Sëmundja Lyme		0.00	2	0.11
HIV	2	0.11	2	0.11
IST	16	0.90	18	1.01
Askariaza		0.00		0.00
Giardiaza	5	0.28		0.00
*Sëmundjet tjera ngjitëse	18	1.01	23	1.29
Gjithsej	19212	1078.04	18760	1052.68
*Sëmundjet tjera ngjitëse: Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza				

Grupi i sëmundjeve të raportuara në mënyrë individuale:**Sëmundjet vaksinëpreventabile:**

Gjatë muajit mars 2025, nga gjithsej 9 raste të testuara si raste të dyshimta me Morbill nga laboratorit i mikrobiologjisë i IKShPK-së, janë raportuar 3 raste pozitive, prej të cilëve gjatë hulumtimit epidemiologjik kemi siguruar të dhënat se 2 prej tyre nuk kanë status të rregullt vaksinal dhe i treti me vetëm një dozë të vaksinës MMR. Rastet e konfirmuara sipas komunave: Gjakovë (2 raste), Deçan (1 rast), sipas gjinisë 2 raste i takojnë gjinisë mashkullore dhe 1 rast asaj femërore. Sipas grup-moshës; 0-1 vjeç (1 rast), 2-3 vjeç (1 rast) dhe 12-13 vjeç (1 rast)

Gjatë muajit mars 2025, nga laboratorit mikrobiologjik i IKShPK-së, është konfirmuar 1 rast pozitiv me Parotit. Rasti është nga komuna e Prishtinës dhe i takonë gjinisë mashkullore dhe ka vetëm një dozë të vaksinës MMR .

Gjatë muajit mars 2025, nga laboratorit mikrobiologjik i IKShPK-së janë konfirmuar 3 raste pozitive me Pertussis, prej të cilëve gjatë hulumtimit epidemiologjik kemi siguruar të dhëna se 2 prej tyre kanë status të rregullt vaksinal. Rastet e konfirmuara sipas komunave: Prishtinë (1 rast), Drenas (1 rast) dhe Vushtrri (1 rast). Sipas grup-moshës: 2-4 vjeç (1 rast) dhe 10-18 vjeç (2 raste). Sipas gjinisë 1 rast i takon gjinisë femërore dhe 2 raste i takojnë gjinisë mashkullore.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe kohore është konfirmuar 1 rast pozitiv me Rubeollë. Rasti është nga komuna e Drenasit dhe i takon gjinisë mashkullore. Gjatë hulumtimit epidemiologjik kemi siguruar të dhëna se rasti i kontaktur, nuk ka status të rregullt vaksinal.

Zoonozat dhe sëmundjet transmise:

Gjatë muajit mars nga ky grup i sëmundjeve nga laboratorit i Mikrobiologjisë në IKShPK, janë raportuar 5 raste pozitive në Brucellozë dhe 1 me Tularemi.

Sipas komunave rastet pozitive me Brucellozë (4 raste nga Prizreni dhe 1 rast nga Rahoveci), rasti me Tularemi është nga komuna e Skënderajit. Të gjitha rastet i përkasin gjinisë mashkullore. Sipas moshës rastet i takojnë grup-moshave: 70-79 vjeç (1 rast), 40-49 vjeç (2 raste), 30-39 vjeç (1 rast) dhe 10-19 vjeç (2 raste).

Nga këto raste, janë hospitalizuar në Klinikën Infektive 1 rast me Brucellozë nga Rahoveci dhe rasti me Tularemi, derisa rastet tjera janë trajtuar në mënyrë ambulantore.

Nga anketimi epidemiologjik i pacientave kuptuam se: rastet janë sporadike pa ndonjë lidhshmëri me njëra tjetrën. Rastet me Brucellozë janë si pasojë e kontaktit direkt me kafshët.

Gjatë muajit mars janë raportuar 2 raste me borreliozë, prej të cilave sipas komunave 1 rast Ferizaj dhe 1 rast Istog. Sipas grup moshave 1 rast i grup moshës 10-19 vjeç dhe 1 rast i grup moshës 60-69 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 1 rast është i gjinisë femërore dhe 1 rast i gjinisë mashkullore.

Sindroma meningjeale:

Gjatë muajit mars, 2025 janë raportuar 13 raste me Sindromë Meningjeale (Mb. 0.72/100 000 banorë), prej tyre 9 raste me Meningjit akut viral, 2 raste me Meningoencephalitis akut, 1 rast me Meningjit purulent dhe 1 rast me Sepsis meningokoksike. Ky numër i rasteve të raportuara është më i lartë krahasuar me periudhën e vitit 2024, ku ishin të raportuara gjithsej 8 raste (6 raste me Meningjit akut viral dhe 2 raste me Meningjit bakterial).

Sa i përket grup- moshës, gjatë kësaj periudhe, rezulton se numri më i madh i rasteve i takon grup- moshës 60-69 vjeç 30%(3 raste), grup- moshë 0-9 vjeç me 20%(2 raste), kurse grup- moshat 10-19 vjeç, 20-29 vjeç, 30-39 vjeç, 40-49 vjeç dhe 50-59

vjeç me nga 10% (1 rast) të raportuar. Sipas komunave, 4 raste janë raportuar në komunën e Prishtinës, me nga 2 raste në Ferizaj dhe Mitrovicë dhe me nga 1 rast komunat: Gjakova, Gjiçani, Drenasi, Kamenica dhe Viti kurse Incidenca më e lartë e rasteve në 100,000 banorë është raportuar nga komuna e Mitrovicës dhe Kamenicës me nga 3/100,000 banorë.

Sa i përket grup- moshës, gjatë kësaj periudhe, rezulton se numri më i madh i rasteve i takon grup- moshës 0-9 vjeç 53.8% (7 raste), grup moshë 60-69 vjeç 15.3% (2 raste) kurse grup moshat 10-19, 20-29, 30-39, 80 vjeç + me nga 1 një rast të raportuar (7.6%). Sipas gjinisë, rezulton se 61.5 % (8 raste) i takojnë gjinisë mashkullore dhe të gjinia femërore me 38.5 % (5 raste).

Nga mostrat humane të testuara në laboratorët e Mikrobiologjisë në IKShPK dhe laboratorin mikrobiologjik në Klinikën Infektive, janë izoluar 8 shkaktarë në LCS, prej tyre: 2 raste me Epstein Barr Virus dhe me nga 1 rast: Neisseria meningitidis, Human adenovirus, Citomegalovirus, HHV6, HHV7 dhe Enterococcus faecalis.

Sëmundjet që barten me ujë dhe ushqim:

Gjatë muajit mars 2025 janë raportuar 30 raste me Gastroenterokolit dhe 19 raste me Helmim me ushqim. Sipas shkaktarëve të izoluar në Laboratorin e Mikrobiologjisë në IKShPK dhe Kl. Infektive, janë raportuar: 5 raste me Salmonellë prej të cilave sipas komunave janë 5 raste Prishtinë. Sipas grup moshave: dy raste janë të grup moshës 0-9 vjeç ndërsa nga një rast i grup moshave 20-29 vjeç, 50-59 vjeç dhe 80-89 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 3 raste janë të gjinisë femërore dhe dy raste i gjinisë mashkullore. 7 raste me Rotavirus prej të cilave sipas komunave janë 5 raste Prishtinë, 1 rast Lipjan dhe 1 rast Kamenicë. Sipas grup moshave 4 raste janë të grup moshës 0-4 vjeç, 2 raste të grup moshës 5-9 vjeç dhe 1 rast i grup moshës 20-29 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 4 raste janë të gjinisë femërore dhe 1 rast i gjinisë mashkullore. 3 raste me Adenovirus prej të cilave sipas komunave janë 2 raste Prishtinë dhe 1 rast Lipjan. Sipas grup moshave të tre rastet janë të grup moshës 0-4 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 1 rast është i gjinisë femërore dhe 2 raste të gjinisë mashkullore. 1 rast me Enterovirus, nga komuna e Prishtinës, e gjinisë femërore dhe i takon grup moshës 0-9 vjeç dhe 1 rast me Norovirus, nga komuna e Prishtinës, e gjinisë femërore dhe i takon grup moshës 0-9 vjeç.

Sëmundjet/Infeksionet respiratore

Gjatë muajit mars 2025 janë testuar 353 mostra të dyshimta në Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë. Prej tyre, 317 (89.8%) mostra të testuara nga qendrat sentinel dhe 36 (10.19%) nga qendrat jo sentinel. Nga mostrat e testuara janë konfirmuar 91 raste me Influcencën A dhe B apo pozitivitet prej 25.77%. Sipas tipit: Influcencë A (29 raste apo 8.21%) dhe Influcencë B (62 raste apo 17.56%).

Nga patogjenët tjerë respiratorë janë raportuar 16 (4.53%) mostra pozitive me RSV, 27 (7.64%) mostra pozitive në Human Rhinovirus, 17 (4.81%) mostra pozitive në Human Adenovirus dhe 17 (4.81%) mostra pozitive në Metapneumovirus.

Mbikëqyrja me Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë vazhdon sipas rekomandimeve të ECDC, WHO për sezonën 2024/2025 si dhe Buletinën javor për Influcencë me të dhënat e përditësuara nga mbikëqyrja epidemiologjike dhe virologjike. Rastet pozitive në Influcencë A dhe B i përkasin komunave: Prishtinë (37 raste), Mitrovicë (22 raste), Suharekë (6 raste), Vushtrri (4 raste), Drenas (4 raste), Fushë Kosovë (2 raste), Lipjan (2 raste), Ferizaj (2 raste), Obiliq (2 raste) dhe me nga një rast komunat : Skenderaj, Prizren , Pejë , Gjiçan, Gjakovë, Rahovec, Shtime, Klinë, Istog dhe Novobërdë.

Rastet pozitive në virusin sincicial (RSV) sipas komunave dhe grupmoshës : Prishtinë (5 raste), Skenderaj (2 raste) dhe me nga një rast komunat : Drenas, Ferizaj, Fushë Kosovë, Kamenicë, Lipjan, Mitrovicë, Prizren, Rahovec dhe Viti. Sipas

grupmoshës, me Influcencë A dhe B : grupmosha 0-4 (125 raste), 5-14 (100 raste), 15-34 (29 raste), 51-64 (18 raste), 35-50 (11 raste) dhe grupmosha 65+ (4 raste).

Prej 91 rasteve pozitive me Influcencë A dhe B, 17 prej tyre janë të hospitalizuar në Klinikën Infektive, 47 në Klinikën e Pediatriisë dhe 1 në Klinikën e Pulmologjisë. Gjatë muajit mars 2025, është raportuar një rast i vdekjes me Influcencë A, nga komuna e Prishtinës, i gjinisë mashkullore, grup-moshë 65+ dhe me sëmundje kronike përcjellëse.

Gjatë muajit mars 2025, përmes Sistemit të Mbikqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse, u raportuan gjithsej 19 raste me SARI. Të gjithë këta pacientë, sipas protokollit dhe kërkesave të klinikistit, u testuan së paku në tre viruse respiratore, SARS-CoV-2, Influenca dhe RSV. Prej tyre 2 pacientë rezultuan pozitiv në Influcencë B, 1 pozitiv në virusin sincicial (RSV) dhe 1 pozitiv në Human Rhinovirus (HRV).

Rastet SARI sipas komunave janë: Gjakovë (7 raste), Prishtinë (3 raste), Rahovec (3 raste), Tropojë-Shqipëri (2 raste) dhe me nga një rast komunat: Prizren, Pejë, Kamenicë dhe Londër. Numri më i lartë i rasteve SARI sipas grup moshës është : 0-4 vjeç (8 raste), mbi 65 vjeç (5 raste), 35-50 vjeç (2 raste), 5-14 (2 raste) dhe me nga një rast grup-moshat 15-34 vjeç dhe 51-64 vjeç. Sipas gjinisë, 10 prej tyre i takojnë gjinisë mashkullore dhe 9 gjinisë femërore.

Gjatë muajit mars 2025, përmes Sistemit të Mbikqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse, nuk është raportuar asnjë rast i vdekjes me SARI.

Gjatë muajit mars 2025, përmes Sistemit të Mbikqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse nga 5 komuna janë raportuar 81 raste me TB (Inc.4.55/100,000 banorë) shih Tabela 1 dhe 2.

Rastet me HIV/AIDS/IST, mars 2025

Gjatë muajit mars 2025, janë raportuar dy raste me HIV. Rastet i takojnë gjinisë mashkullore, grup moshë 25-34 vjeç (komuna Lipjan) dhe 45-54 vjeç (komuna Prishtinë). Rruga e transicionit tek të dy rastet është homoseksuale (MSM).

Rasti nga komuna e Lipjanit është raportuar nga Departamenti i Mikrobiologjisë me MedLis (pacienti akoma nuk është lajmëruar në Klinikën Infektive, prandaj dhe mungon raportimi me SMSN), përderisa rasti tjetër është raportuar përmes MedLis dhe SMSN.

Ecuria e Infeksioneve Seksualisht të Transmetueshme (IST), mars 2025

Gjatë muajit mars 2025 janë raportuar gjithsej 18 raste me Infeksione Seksualisht të Transmetueshme. Rastet e raportuara janë nga komunat: Ferizaj 9 raste, Kaçanik 2 raste, Pejë 2 raste, Shtime 2 raste, Prishtinë 1 rast, Podujevë 1 rast dhe Gjilan 1 rast.

Sipas diagnozës: Chlamydia 13 raste, Condyloma 4, dhe Gonorreja 1 rast. Sipas gjinisë: 14 raste i takojnë gjinisë femërore dhe 4 raste gjinisë mashkullore. Sipas grup moshës 25-49 vjeç i takojnë 16 raste dhe 15-24 vjeç, 2 raste.

Tri raste janë raportuar përmes SMSN, nga ana e Klinikës së Dermatovenerologjisë, 12 raste janë raportuar me anë të postës elektronike nga ana e një laboratorit privat në Ferizaj përmes QRShP Ferizaj, dy raste janë raportuar me anë të postës elektronike nga ana e një laboratorit privat në Pejë përmes QRShP Pejë dhe një rast me anë të formës raportuese me letër dhe është sjell në dorë nga ana e QKMF Prishtinë.

Hepatiti akut B dhe Hepatiti akut C, mars, 2025

Gjatë muajit mars, 2025 janë raportuar **4 raste** me Hepatit akut B (**Mb. 0.22/100 000 banorë**). Ky numër i rasteve të raportuara është përafërsisht i njëjtë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 ku ishin të raportuara 4 raste me Hepatit akut B. Sipas komunave, janë raportuar me nga 1 rast: Prizren, Fushë Kosovë, Klinë dhe Podujevë. Sa i përket grupmoshës, 30-39 vjeç me 50% (2 raste), 40- 49 vjeç me 25% (1 rast) dhe grupmosha 60- 69 vjeç me 25% (1 rast). Sipas gjinisë rezultojnë se i takojnë gjinisë mashkullore (4 raste).

Gjatë kësaj periudhe nuk është raportuar asnjë rast me dg. Hepatit akut C.

Rastet e sëmundjeve ngjitëse në Kosovë sipas komunave, mars 2025

Tabela 2.

Annex 1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse sipas komunave, mars-2025																														
SËMUNDJA	Pneumonia/ARI	SARI	ILI	Diarrheac	Varicella	Influenca A	Influenca B	RSV	Sindroma meningjeale				**Morbilli	Rubeolla	Parotitis epidemica	Pertussis	Hepatit ac. B	Hepatit ac. C	Helminet me ushqim	Gastroenterokolitet	Bruceloz a	Tularem i	Salmonelloza	Rotavirus	Borelioza (Lyme Disease)	IST	HIV	TB	Sëm.tjera ngjitëse	Totali
KOMUNA									Meningjit serosa	Meningjit purulent	Meningoencephalitis ac.	Sepsis Meningococcica																		
DEÇAN	0		212	34	3							1						1											251	
DRAGASH	23		170	44	3																								240	
DRENAS	99		212	70	10	2	2	1			1		1		1														1	400
F. KOSOVË	64		651	127	15		1	1								1		1	2											863
FERIZAJ	18		257	110	15			1	2										3					1	9			9		425
GJAKOVË	18	7	21	5	1		1		1			2							2										1	59
GJILAN	33		712	211	37				1										1							1				996
GRAÇANICË																														0
H. I ELEZIT	14		136	7	7																									164
ISTOG	10		165	36																					1					212
JUNIK	0		67	12																										79
KAÇANIK	7		146	66	9															1					2					231
KAMENICË	0	1	497	86	1			1	1															1						588
KLINË	32		205	83	15		1									1														337
KLOKOT																														0
LEPOSAVIQ																													1	1
LIPJAN	0		0	0	0		2	1												3				2			1	1	1	11
MALISHEVË	8		263	46	11																									328
MAMUSHË	2		39	6	3																									50
MITROVICË	63		858	378	24	3	17	1	1	1																		9	9	1364
MITROVICË E VERIUT																														
N. BËRDË	0		20	11	0	1																								0
OBILIQ	15		187	65	8	1	1																							32
PARTESH																														277
PEJË	7	1	440	248	3		1																	1		2				0
PODUJEVË	16		625	102	24											1			2	2						1				773
PRISHTINË	1308	3	3922	1079	97	12	15	4	2		1	1		1	1				13	12			5	9		1	1		3	6490
PRIZREN	32	1	966	448	52			1								1					4							61		1566
RAHOVEC	9	3	18	14	0			1												4	1									50
RANILLUG																														0
SHTËRPCE																														0
SHTIME	11		357	53	4		1												2							2				430
SKËNDERAJ	15		81	45	2	1		2													1								1	148
SUHAREKË	22		747	146	2	1	1																						1	920
VITI	8		397	106	1			1	1																					514
VUSHTRRI	42		146	35	24		1								1														6	255
Z. POTOK																														0
ZVEÇAN																														0
BURGU I LIPJANIT																														0
PA ADRESË		3																												3
TOTALI	1876	19	12547	3673	371	21	44	15	9	1	2	1	3	1	1	3	4	0	19	30	5	1	5	13	2	18	2	81	23	18760

*Sëmudnjët tjera ngjitëse: , Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza


3. RASTET E SPITALIZUARA NË KLINIKËN INFEKTIVE, PEDIATRI DHE SPITALET RAJONALE NGA SËMUNDJET NGJITËSE NË KOSOVË GJATË MUAJIT MARS 2025

Rastet e spitalizuara nga sëmundjet ngjitëse në numër më të madh janë raportuar nga pneumonitë, infeksionet virale të traktit respiratorë, diaretë akute dhe gastroenterokolitet nga të cilat vetëm disa kanë konfirmim laboratorik të shkaktarit pasuar nga rastet tjera të cilat raportohen sipas diagnozës klinike. (shih tabela 3).

Rastet e spitalizuara në Klinikën Infektive, Pediatri dhe spitalet rajonale nga sëmundjet ngjitëse në Kosovë, gjatë muajit mars 2025

Tabela 3.

Sëmundja/shkaktari	Numri i rasteve
Pneumonia /ARI	125
SARI	19
Diarea akute dhe gastroenterocolite	126
Sëmundje e ngjashme me gripin (ILI)	11
Influenca A dhe B	65
Variçella	6
Hepatitis B	4
Morbill	3
Sindroma meningjeale	13
Helmimet me ushqim	17
Brucellozë	1
Tularemi	1
Salmonelloza	5
Lyme Disease (Borelioza)	2
Mononucleosis	4
Erysipela	4
Exanthema	4
Leishmaniaza	1
Totali	411



4. EPIDEMITË E LAJMËRUARA GJATË MUAJIT MARS 2025

Gjatë muajit mars 2025, nuk është raportuar asnjë epidemi.

5. NIVELI I RAPORTIMIT NGA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE

Për këtë periudhë, kanë raportuar 28 komuna ose 73.68% (28/38) e tyre. Komunitat të cilat nuk kanë raportuar: Lipjan, Graçanicë, Klllokot, Leposaviq, Mitrovicë e veriut, Partesh, Ranillug, Shtërpce, Zveçan dhe Z.Potok.

Tabela 4. Raportimi i sëmundjeve ngjitëse nga institucionet përmes SMSN

Institucioni shëndetësor	Numri i rasteve
Klinika e Dermatovenerologjisë	2
Klinika e Pediatriisë	15
Klinika e Sëmundjeve Ngjitëse- Infektive	170
QKMF - Fushë Kosovë	65
QKMF - Gjakovë	105
QKMF - Gjilan	2
QKMF - Kamenicë	2
QKMF - Podujevë	19
QKMF - Prishtinë	4
QKMF - Prizren	29
QKMF - Skenderaj	2
QKMF - Vushtrri	2
QMF - 1	29
QMF Cermjan	4
QMF Druar	2
QMF IV Ferizaj	1
QMF Lluzhan	3
QMF Orize	34
QMF Orllan	5
QMF Ponosheci	41
QMF Rahoveci	28
QMF Ratkoc	8
QMF Rogovë	23
QMF Smrekonicë	2
QMF-1	26
QMF-2 Lakuriq	12
QMF-3 Kurila	3
QMF-IV	10
QMF-Mat	1
QMF-Mat 1	3
QMF-V	1
QMF-XI	7
Spitali i Përgjithshëm në Gjakovë	88
Spitali i Përgjithshëm në Mitrovicë	5
Spitali i Përgjithshëm në Vushtrri	13
Totali	766


Gjatë muajit mars 2025, përmes SMSN nga 36 institucione shëndetësore janë raportuar gjithsej 766 raste me sëmundje ngjitëse. Ky numër krahasuar me muajin shkurt 2025 me 403 raste të raportuara (12 institucione) shënon një rritje graduale të numrit të rasteve të raportuara përmes SMSN.

6. COVID-19

Gjatë muajit mars 2025, janë testuar 482 mostra të dyshimta në COVID-19 dhe të gjitha kanë rezultuar negativ në SARS-CoV-2, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024 me (4 raste pozitive të raportuara),

Në Kosovë varianti i SARS-CoV-2 Omicron BA.2.86 dhe subvariantet e tij, përfshirë KP.3, dominojnë në mesin e mostrave të testuara pozitive në virusin SARS CoV-2, në periudhën një-mujore nga 10 Korrik deri 9 Gusht 2024. Nga variantet kemi: 53% për Variantin KP.3 (44 detektime) dhe 47% për Variantin BA.2.86 (39 detektime). Rrjedhimisht, prania e nën-linjave të variantit të Omicronit të SARS-CoV-2 në Kosovë është në përputhje të përafërt me epidemiologjinë virologjike të SARS-CoV-2 në vendet tjera Europiane, përkatësisht me dominim të variantit KP.3. Aktiviteti i SARS-CoV-2 ka pësuar një rënie, me nivele pozitiviteti më të ulëta krahasuar me vitin 2023. Situata mbetet e ndryshme në nivel të të gjitha shteteve raportuese, me individët mbi 65 vjeç më të prekur nga sëmundjet e rënda të COVID-19.

Grafikoni 1. Numri i rasteve të testuara, të konfirmuara me COVID-19, mars 2025



7. SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE NË RAJON DHE BOTË, MARS 2025

Situata epidemiologjike me fruth në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Më 11 mars 2025, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) mori një raport nga Rregullorja Ndërkombëtare e Shëndetit (2005) (IHR) e Shteteve të Bashkuara të Amerikës mbi shpërthimet e vazhdueshme të fruthit në vend.

Fruthi është një sëmundje virale shumë ngjitëse, e transmetuar përmes ajrit, që mund të çojë në komplikime të rënda dhe vdekje. Nga 1 janari deri më 20 mars 2025, 17 shtete kanë raportuar gjithsej 378 raste të fruthit, duke përfshirë dy vdekje - vdekjet e para të lidhura me fruthin në Shtetet e Bashkuara në një dekadë. Dy vdekjet e raportuara, një e konfirmuar në Teksas dhe një nën hetim në New Mexico. Shumica e rasteve janë te fëmijët që janë të pavaksinuar ose me status të panjohur vaksinimi dhe shkalla e përgjithshme e hospitalizimit është 17%.

Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve të Shteteve të Bashkuara (USCDC) dhe agjenci të tjera qeveritare po punojnë për të kontrolluar shpërthimet me Fruth.

Në vitin 2000, fruthi u shpall i eliminuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që atëherë janë zbuluar raste të importuara të fruthit në vend, pasi sëmundja mbetet endemike në shumë pjesë të botës.

Nga 1 janari deri më 20 mars 2025, 378 raste janë raportuar nga 17 shtete, duke përfshirë: Alaska, Kaliforni, Florida, Gjeorgji, Kansas, Kentaki, Maryland, Michigan, New Jersey, New Mexico, New York State, Ohio, Pennsylvania, Rhode Island, Texas, Vermont dhe Washington.

Pasqyra epidemiologjike e infeksioneve me virus respirator, mars 2025

Bazuar në të dhënat e raportuara në mars 2025, normat e konsultimeve të kujdesit parësor dhe dytësor sugjerojnë një kthim në nivelet e ulëta ose bazë të aktivitetit të virusit të frymëmarrjes në shumicën e vendeve raportuese të BE/ZEE.

Trendet në rënie të aktivitetit të gripit po vërehen pothuajse në të gjitha vendet, ku dy të tretat e vendeve raportuese janë kthyer në nivele bazë ose të ulëta të intensitetit të gripit. Viruset e influencës A(H3) dhe B u raportuan më së shpeshti në javën e 14-të. Aktiviteti i RSV në BE/EEA mbetet i ngritur, i nxitur nga rreth një e treta e vendeve të BE/ZEE që kanë përjetuar një sezon të mëvonshëm. Të dhënat e raportuara në këtë muaj sugjerojnë se aktiviteti maksimal mund të jetë arritur tani në shumë prej këtyre vendeve.

Aktiviteti SARS-CoV-2 mbetet në nivele të ulëta në të gjitha vendet.

8. REKOMANDIMET

Për ngritjen e kualitetit të raportimit, mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse dhe aplikimin e masave parandaluese dhe kundërepidemike me kohë rekomandojmë:

Bazuar në Ligjin për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse Nr.08/L-200, Neni 20 dhe 21 të gjitha Institucionet shëndetësore obligohen të raportojnë në IKSHPK/QRSHP sipas listës së sëmundjeve ngjitëse Aneksi 1 i këtij ligji.

Raportimi i sëmundjeve të bëhet përmes sistemit të digjitalizuar të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse në të gjitha nivelet me qëllim të sigurimit të të dhënave në kohë reale, të dhëna kualitative dhe pasqyrë reale të situatës epidemiologjike për parandalim dhe kontrollë të sëmundjes.

INSITUTI KOMËTAR I SHËNDETËSISË**PUBLIKE TË KOSOVËS****Departamenti i Epidemiologjisë****Adresa: Rr. Nëna Terezë (p.n) rrethi i spitalit, Prishtinë 10000****WebFaqe: <http://www.niph-rks.org>****E-mail: ariana.kalaveshi@rks-gov.net****Telefoni+38338 551432, ext. 1013**

